



Njoftim

Radio Televizioni Shqiptar, në kuadër të përgatitjes për sezonin e ri , shpall konkurs për rikonceptimin e identitetit, logos, sinjalistikes dhe siglave grafike për kanalet e platformës RTSH.

Rtsh 1
Rtsh 2
Rtsh 3
Rtsh Film
Rtsh Sport
Rtsh Shqip
Rtsh Muzikë
Rtsh Agro
Rtsh Shkollë
Rtsh Gjirokastra
Rtsh Korça
Rtsh Kukësi
Rtsh Plus

Paketa grafike duhet të përmbajë:

1. Rikonceptimi i identitetit të RTSH

Në këtë element do të përfshihen zërat:

- a) Koncepti dhe ideja e logos së re zyrtare të RTSH;
- b) Forma e logos së re zyrtare të RTSH, me të cilën kuptohet gjeometria e logos dhe përmasat e saj;
- c) Logo e re zyrtare e RTSH, me të cilën kuptohet krijimi grafik viziv nëpërmjet të cilës personalizohet Radiotelevizioni Shqiptar;
- d) Logo e re televizive e RTSH, me të cilën kuptohet krijimi grafik viziv nëpërmjet të cilës personalizohen kanalet televizive të platformës transmetuese të RTSH;
- e) Pantonet e logos së re zyrtare të RTSH dhe të logos së re televizive të RTSH, me të cilën kuptohen ngjyrat e logos me kodet përkatëse të tyre;
- f) Tipografia e logos së re zyrtare të RTSH dhe të logos së re televizive të RTSH, me të cilën kuptohet lloji i gërmave të përdorura në secilën logo;





- g) Logot e reja televizive të kanaleve televizivë të platformës transmetuese të RTSH;
- h) Logo e re zyrtare e RTSH, që do të përdoret në kancelari, në vulën e RTSH, në letrat të formateve të ndryshme, të zarfeve të formateve të ndryshëm;
- i) Logo e re zyrtare e RTSH, që do të përdoret në reklamat outdoor (postera, banera, billboarda, citylighte), ku përfshihet edhe Brand-imi i Makinave dhe Brand-imi i mikrofonave;
- j) Paketa e paraqitjes grafike të materialeve autoreklamuese dhe promocionale të RTSH;
- k) Paketa e paraqitjes grafike në rrjetet sociale në instagram, facebook, linkedin, twitter, e-mail.

Të gjitha elementët duhet të jenë në format digjital.

2. Siglat grafike për kanalet e platformës transmetuese të RTSH

Në këtë element do të përfshihen:

- 1) Sigla "Identitete autoreklamuese RTSH";
- 2) Sigla "Identitete për festat kombëtare dhe sezonale";
- 3) Sigla "reklama" video;
- 4) Sigla "pas pak" video;
- 5) Pop up on screen "pas pak";
- 6) Sigla "Programi ditor" video;
- 7) Paketa e spoteve video;
- 8) Spot i përgjithshëm autoreklamues RTSH;
- 9) Paketa e Lajmeve. Revisata Televizive;
- 10) Sigla "Moti";
- 11) Shenjat konvecionale për moshën e audioncës;
- 12) Shenjat "drejtpërdrejtë dhe ritransmetim";
- 13) Strisha on screen për transmetimet dhe evenetet e veçanta.

Të gjitha elementët duhet të jenë në format digjital.





3. Sinjalistika e RTSH

Në këtë element do të përfshihen:

- a) Logot;
- b) Hartat;
- c) Tabelat dhe shenjat orientuese.

Të gjitha elementët duhet të jenë në format digjital.

Subjekti duhet të paraqesë manual përdorimi në formë të printuar dhe në formë digjitale për:

- a) Aplikimi i logos së re zyrtare të RTSH-së;
- b) Si nuk duhet të përdoret logoja e re zyrtare e RTSH-së;
- c) Hapësirat e lejuara të logos së re zyrtare të RTSH-së

Ftojme të gjithë krijuesit, studiot grafike dhe agjensitë e komunikimit të paraqesin idetë e tyre deri më dt. 10 Gusht 2020.

Materialet duhet të dërgohen elektronikisht në adresën: grafika@rtsh.al

ose të paraqiteni për të kontaktuar me Drejtorinë e Grafikës pranë RTSH në adresën: Rr. Ismail Qemali Nr.11, Tiranë

